



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31004-00951-80-2017 Data e Regjistrimit : 10/02/2017
Numri i Vendimit: 80-2017-2624 Data e Vendimit : 12/06/2017

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 12/06/2017mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Shoqeria "{...}" sh.p.k, I Paditur DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

Objekti:Shfuqizimin e Vendimit te Bordit te Apelimit te DPPM me nr. 369/8 prot, date 18.10.2016 dhe Detyrimin e DPPM te bej regjistrimin e markes {...} (ijale) te aplikuar me nr. AL/T/2015/369, depozituar me date 12.06.2015 dhe publikuar ne date 02.11.2015 ne buletin e markave te DPPM nr.05/2015. 2.

Detyrimin e pales paditese te paguaje shpenzimet gjyqesore

Baza Ligjore: 12.05.1999 i shfuqizuar; Ligji 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise, botuar ne FZ 87/2015 ne fuqi; Ligji nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" (i ndryshuar); Vendim e Keshillit te Ministrave Nr. 1706, date 29.12.2008 "Per miratimin e rregullores per regjistrimin e markave tregtare dhe te sherbimit" i ndryshuar;

Ne perfundim te seances gjyqesore te dates 12.06.2017, te zhvilluar ne prani paleve ndergjyqese, Gjykata degjoi paditesin shoqeria {...} sh.p.k, qe permes perfaqesuesit te saj i kerkoi gjykates pranimin e kerkesepadise sipas objektit me aresyetimin ne menyre te permbledhur se :

- Paditesi eshte pronar i markes tregetare te mirenjohur {...}, e cila ehste nje marke e rregjistruar, njohur dhe mbrojtur edhe nderkombetarisht.
- Paditesi ka nje game te gjere produktesh mes te cilave edhe pije jo alkalike dhe energjitike. Nje nder ta eshte dhe pija energjitike {...}.
- Pala e paditur ka rrefuzuar te rregjistroje me fjale marken {...} me argumentin se krijohet konfuzion me marken {...}.
- Vendimi i pales se paditur eshte nje vendim i cili eshte i pabazuar ne ligj e ne prova, pervecse ne shkeje te vete qendrimeve te mbajtura ne raste te ngjajshme nga vete organi administrative/i padituri.
- Ngjajshmeria duhet te jete evidente dhe e provuar jo vetem per nga gama e produktit qe eshte pije energjike, por dhe nga emertimi.
- Pretendimi i pales se paditur shprehur ne vendimin objekt gjykimi eshte i pabazuar pasi jemi para dy markave te ndryshme te mbrojtura me dy klasa te ndryshme qe kane dallime ne pamje, ne kuptim te fjales se perdorur per te identifikuar marken etj.

Degjoi palen e paditur D.P.Industriale qe permes juristes {...} kerkoi rrezimin e padise me aresyetimin sa vijon permbledhur;

- Vendimarrja e pales se paditur eshte e bazuar ne ligj e ne fakt. Konkretisht eshte rrefuzuar rregjistrimi i aplikimit te paditesit per shkak se krijohen tek konsumatori final konfuzion.
- Konfuzioni vjen si rrezultat i ngjashmerive qe jane konceptuale, fonetike, si dhe ne klasen e mallrave dhe sherbimeve.

Degjoi konkluzionet e personit te trete {...} Internacional qe permes av.{...} kerkoi rrezim te padise duke aresyetuar ne menyre te permbledhur sa vijon:

- Padia duhet rrezuar pasi ajo eshte ngritur ne tejkalim te afateve te lejuara ne ligj. Konkretisht afatet filojne te ecin nga dita e marrjes dijeni per vendimin dhe jo nga e nesermja sikurse pretendoi paditesi.
- Sa i perket themelit te pretendimeve ato nuk qendrojne pasi marka {...} eshte nderkombetarisht e mbrojtur dhe e mirenjohur.
- {...} eshte pervecse tregetues i produkteve ushqimore dhe prodhues i tyre. Nje nder produktet eshte dhe pija energjike e cila cenohet dpd nga pretendimi i paditesit.
- Nese do te rregjistrohej marka {...} per klasen pije energjike personit te trete do i shkaktohej dem i rende pasi kjo do te krijonte konfuzion tek konsumatori final. Kjo vjen jo vetem nga ngjashmerite ne emertim dhe ne pamje por dhe ne klase qe jane te njejta identike pije energjike.

dhe pasi administroi provat e paraqitura nga pala paditese ne seance gjyqesore,

VEREN :

Veren:

Se paditesi "{...}" sh.p.k, I eshte drejtuar gjykates se Administrative te shk.I Tirane me nje kerkesepadi me objekt "Shfuqizimin e vendimit nr. (...)" dhe me pale te paditur DPMP Tirane dhe person te trete {...} Internacional BV. Ne gjykim me kerkesa te paditesit u be kalimi procedural nga DPMP ne DPP Industriale, per shkak te ndryshimit te emerteses se organit administrativ qe ka nxjerre aktin objekt gjykimi.

Gjate shqyrtimit gjyqesor rezultoi e provuar se :

Paditesi{...} sh.p.k, eshte nje shoqeri tregetare me seli ne Tirane, me pronar shoqerine meme {...} me seli ne R.Kosoves. kjo e fundit ka ne pronesi te saj marken tregtare te pijes energjike {...}, pronesi e fituar nepermjet aplikimit ne vendin e origjines, prane regjistrimit te markave tregtare te shtetit te Kosoves. Paditesi ka bere nje aplikim per regjistrim prane DPMP per te shtrire efektet e mbrojtjes se markes se saj edhe ne Shqiperi. Nga ana tjeter nje tjeter shoqeri tregetaree me origjine nga Hollanda {...} internacional ka rregjistruar nderkombetarisht sio dhe ne vendin tone marken {...}. Nga shoqeria {...} Internacional duke pretenduar ngjajshmerine mes dy markave tregtare, duke pretenduar cenim te imazhit dhe te interesit te saj tregetar te mbrojtur nderkombetarisht I eshte drejtuar me nje kundersiztim rregjistrimi Bordit te Apelimit prane DPMP Tirane. Nga ana e pales se paditur permes vendimit nr.369/8, dt.18.10.2006, eshte rrezuar kerkesa e paditesit duke u arritur ne konkluzionin produkti I paditesit {...} pije energjike me mbishkrimin {...}, cenon interesat e paditesit duke permendur vec tjerave dhe faktin se {...} eshte nje marke nderkombetare e rregjistruar dhe e mbrojtur ne edhe ne RSh. Pavaresisht argumentave te pales se paditur parashtruar ne aktin e saj, pala paditese eshte paraqitur ne gjykate permes padise objekt gjykimi duke pretenduar se nuk ka asnje ngjashmeri mes markave pasi marka e paditesit qe kerkohet te rregjistrohet "{...}" eshte pije energjike ndersa marka e personit te trete {...} eshte marke e nje linje supermaketesh. Sa me lart u provua ne gjykim nga aktet shkresore si vijon:

- vendim i bordit te apelimit te DPPM nr.369/8prot dt.18.10.2016

- tabele fotografike (12flete)

Ne perfundim te hetimit gjyqesor, Gjykata pasi analizoi gjithë provat e marra gjate hetimit gjyqesor dhe pasi vleresoi bazueshmerine ne ligj dhe prova te pretendimeve te paditesit arriti ne konkluzionin se kerkesepadia eshte e pambeshtetur ne prova ndaj dhe duhet rrezuar. Ky konkluzion mbeshtetet ne argumenta qe do te shtjellohen si vijon:

I.

Sa I perker ndergjyqesise, paditesi ka thirrur ne kete gjykim si pale e paditur vetem DPMP Tirane ndersa shoqerine {...} Internacional nuk e ka thirrur si pale te paditur. Ne rastin konkret cdo vendimarrje e gjykates lidhur me objektin e padise shkakton, se pari pasoja mbi shoqerine {...} Internacional, dhe se dyti mbi organin administrativ. Mbi kete aresyetim dhe avokatura e shtetit relatoi mosprezencen ne kete gjykim, duke e konsideruar si nje konflikt mbi pale me interesa private. Nuk mundet qe nje vendim gjyqesor te krijojte detyrime per nje pale qe eshte thirrur si person trete dhe jo si pale e paditur ne gjykim. Pavaresisht orientimit dhe qendrimin te mbajtur nga gjykata dhe ne raste te ngjajshme nga pala paditese nuk u pa e aresyeshme kryerja e ndryshimeve ne ndergjyqesi.

II.

Ne gjykim personi I trete {...} Internacional pretendoi se padia eshte ngritur tej afateve te parashikuara ne ligj. Konkretisht paditesi, pretendoi ne gjykim se padia duhej te ishte depozituar ne gjykate ne zbatim te afateve te parashikuara ne nenin 155 te ligjit posacem qe parashikon shprehimisht se; "vendimet e Bordit te Apelimit mund te ankimohen ne gjykate brenda 30 diteve nga data e marrjes se njoftimit te vendimit te Bordit. Lidhur me kete pretendim te pales se interesuar rezultoi provuar se paditesi ka marre dijeni per vendimin, aktin objekt gjykimi, me daten 11.01.2017, provuar kjo nga shenimi i sekretarise se DPPI gjendur ne vendimin e Bordit qe kundersiztohet. Ndersa padia eshte depozituar me

daten 10.02.2017. Mbi kete aresyetim ligjor dhe faktik pala e interesuar pretendon se ka kaluar afati 30 ditor i ngritjes se padise. Ne vleresim te gjykates padia objekt gjykimi eshte ngritur brendafateve te lejuara ne ligj per shkak se afati 30 ditor brenda te cilit do te duhej te depozitohet padia ka filluar te ece jo nga dita e shpalljes se vendimit por nga e nesermja e tij. Ne kete konkluzion gjykata mban parasysh sa sanksionon K.Pr.Administrative ne nenin 56, parag.2, i cili ne perlllogaritjene afateve perjashton ditën kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon afati. Ne rastin konkret ngjarja eshte vendimi i bordit te apelimit, i cili perben dhe aktin objekt gjykimi. Ne interpretim dhe zbatim te dispozites se sipercituar, data e dhenies se ketij vendimi apo e njoftimit te tij, per vendimet e dhena ne mungese te paleve, nuk perlllogaritet ne afatet e ankimit.

III.

Pavaresisht pretendimeve te paditesit per qendrim jo konstatant te pales se paditur per raste te ngjajshme, gjykata nuk mund te bazoje vendimin e saj mbi praktikën jo te unifikuara te organit administrativ, pavaresisht se e konstaton ate dhe terheq vemendjen organit administrative per ruajtje te parimit te sigurise juridike ne drejtim te aplikimeve te paleve te interesuara. Sa l perket aktit objekt gjykimi gjykata kete akt e shqyrton mbi bazen e ligjshmerise si dhe te provave mbi te cilin ai eshte bazuar dhe jo mbi bazen e rasteve te ngjajshme qe ka trajtuar pala e paditur.

IV.

Lidhur me themelin e pretendimeve te paditesit gjykata nga analiza e provave me shkrese konkludon se pretendimet jane te pabazuara edhe sa i perket thelbit te tyre, pasi vendimarrja e pales se paditur eshte e mbeshtetur ne fakt e ne ligjin e posacem 9947//2008, i ndryshuar. Konkretisht vendimi i bordit te apelimit duhet te lihet ne fuqi pasi ne gjykim u konstatua sa vijon;

i) *Ngjashmeria ndermjet markave.*

Per te bere nje analize te sakte te ngjashmerise mes markave ne diskutim, duhet te merret ne konsiderate teresia e elementeve perberese te tyre dhe pershtypja e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, por duke u fokusuar me teper ne elementet qe luajne rolin kryesor ne krijimin e karakterit dallues te markave. Markat ne shqyrtim ne rastin konkret jane si vijon:

Marka kundershuese

{...}

Aplikimi i kundeshtuar

Gjykata vlereson se eshte e rendesishme qe ne rastin objekt gjykimi te percaktohet karakteri dallues dhe elementet dominuese te markave ne diskutim. Ne lidhje me kete, konstatohet se markat kundershuese jane marka te perbera nga elemente verbale dhe figurative. Elementi dallues dhe dominant i ketyre markave eshte elementi fjale "{...}". Ky element dominon pershtypjen e pergjithshme, si dhe ka nje paraqitje shume me te dukshme ne raport me elementet e tjera, si sfondi dhe ngjyrat, te cilat kane qellim pikerisht evidentimin e elementit {...}, apo figura *peme e stilizuar* e cila ka permasa shume te vogla ne teresine e markes. Per kete shkak, elementi verbal eshte elementi dominues. Elementi verbal "{...}" gjithashtu permban karakterin dallues ne te gjitha markat kundershuese, sepse ai eshte nje fjale qe ska asnje kuptim te caktuar ne shqip, dhe si i tille gezon nje karakter te theksuar dallues. Ndersa marka e kundeshtuar eshte po gjithashtu vetem fjale "{...}". Ne keto kushte krahasimi i markave perqendrohet ne elementet verbale "{...}" dhe "{...}".

ii) *Ngjashmeria vizuale:*

Ne kete aspekt, me te drejte nga pala e paditur eshte konkluduar se ne te dyja rastet ne konflikt, elementet verbale kane te perbashket nje numer te madh shkronjash te shkruara me shkrim shtypi kapital dhe te pozicionuara ne te njejtin rend "{...}" = "{...}+K". Fjalet perbehen gjithashtu nga e njejta strukture dhe gjatesi fjale e si te tilla ne pikpamjen pamore vleresohen shume te ngjashme.

iii) *Ngjashmeria fonetike:*

Shenjat jane pothuajse identike nga pikepamja fonetike, per shkak se marka e kundeshtuar ka elementin {...} te inkorporuar ne te, ato shqiptohen dhe degjohen njelloj. Diferenca e vetme ne shkronja - germa K, nuk sjell ndryshim relevant, pasi ajo klasifikohet ne gjuhen shqipe si nje bashketingellore e pazeshme, dhe si e tille ka nje influence minimale ne teresine e fjales. Si konkluzion edhe gjykata konkludon se ka nje ngjashmeri te larte fonetike.

iv) Ngjashmeria konceptuale:

Marka kundërshtuese përbehet nga një fjale "{...}", e cila nuk përmban asnjë kuptim të caktuar në shqip, ndërsa marka e kundërshtuar "{...}" e cila po ashtu nuk ka kuptim në Shqip, në fakt ka kuptim në anglisht (shkëndije/xixelloje). Kjo nuk përben një diferencë thelbësore që për pasoje nuk rezulton që konsumatori shqiptar ta njohë domosdoshmërisht kuptimin e saj në anglisht. Në këto kushte krahasimi konceptual në rastin konkret nuk ka vlerë. v) Ngjashmeria mes mallrave dhe shërbimeve:

Lidhur me këto aspekt, gjykata nisur nga klasa e produkteve që përfaqësojnë sejcila nga market konkludon se mallrat dhe shërbimet janë përgjithësisht shumë të ngjashme dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre është edhe identike. Gjukata arrin në këto përfundim bazuar në analizën e mëposhtme: Aplikimi i kundërshtuar ka aplikuar për t'u regjistruar në klasat 32 dhe 35 për mallrat dhe shërbimet si vijon: "32. *Pije freskuese joalkoolike duke përfshirë pijet energjike, pijet me baze birre dhe pijet izotonike (hipertonike dhe hipotonike) për atletet; birra, ujë mineral dhe të gazuar; pije frutash dhe lengje frutash; shurupe, esenca dhe preparate të tjera për përgatitjen e pijeve dhe koktejeve joalkoolike.* 35. *Reklamim; menaxhim biznesi; administrim biznesi; funksione të zyrës.*". Markat {...} janë të mbrojtura tashmë për klasat në diskutim (32 dhe 35) përveç shumë të tjerave, konkretisht: "32 *Birra; uji mineral dhe të gazuar dhe pije të tjera jo-alkoolike përfshirë pije energjike; pije frutash dhe leng frutash; shurup dhe përgatitje të tjera për të bërë pije*". Ndërsa në klasën 35 markat kundërshtuese mbulojnë shërbimet si vijon: IR. 565539- *Reklama dhe shërbime në kombinim me shfrytëzimin ose drejtimin e ndërmarrjeve tregtare, shërbim në lidhje me drejtimin e bizneseve ose të funksioneve tregtare të ndërmarrjeve tregtare*; IR.608847 - *Studim dhe analizë e tregut; promovim i shitjeve, keshilla në lidhje me hulumtimin e tregut dhe të analizës dhe të blerjes, keshilla në lidhje me strategjitë e korporatave, strukturimi i personelit dhe menaxhim biznesi; reklama, përfshirë reklamën që shfaqen në radio dhe televizor, po ashtu edhe nëpër kinema, shpërndarja e materialeve reklamuese, marrëdhënie me publikun, përgatitje e raporteve të eksperteve në lidhje me ceshtjet tregtare dhe menaxhimin e biznesit vecanerisht për tregun ushqimor; organizimi i panairëve dhe ekspozitave tregtare apo për qëllime reklamimi*; IR. 10822638 - *Sherbimet e shitjes me pakicë në supermarkete dhe hipermarkete edhe nëpërmjet internetit; shërbimet e shitjes me pakicë dhe shërbime me shumicë (përkatesisht për shërbimet komerciale ndërmjetese) në lidhje me ushqim dhe pije, pije alkoolike, mallrave shtëpiake, artikuj kimiste gjithashtu duke përfshirë produkte farmaceutike, kozmetike dhe pastrimit, artikuj kopshtarit, artikuj DIY (do it yourself/beje-vete) përfshirë mjetet, mobilje dhe artikuj dekorate në shtëpi, elektronike gjithashtu duke përfshirë aparatet për qëllime shtëpiake, aparate audio dhe video, kamera, aparate e telekomunikacionit, kompjutera, lodra, artikuj sportive, veshje, kapele dhe kepuce, automjetet duke përfshirë bigjileta, shkrimi dhe pjesë dhe pajisje për ushqim lartpërmendur jo produkte; promovimin e shitjes; reklamën; demonstrim i produkteve". Sa më sipër, meqenëse marka e kundërshtuar kërkon mbrojtje për të njëjtat mallra dhe shërbime për të cilat tashmë janë mbrojtur markat e mëparshme, për shkak të ngjashmërisë mes markave si dhe për shkak të se përgjithshme pothuajse të njëjta që shkaktojnë ato tek publiku/konsumatori, që është e lartë, mundësia e shkakimit të konfuzionit, përfshirë edhe mundësia e bashkelidhjes mes markave është e evidente. Sa më sipër gjykata arrin në konkluzionin se aplikimi kombëtar nr. AL/T/2015/369 për regjistrimin e markës {...} (fjale), cenon të drejtat e mëparshme të markave kundërshtuese {...}, në kuptim të nenit 143 pika 2 germa "b" të Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 (i ndryshuar). *Se fundi*; Sa më lart Gjukata konstaton se veprimtaria e palës së paditur është në përputhje me kompetencën e dhënë me ligj, si dhe në rrespekt të formës dhe procedurës specifike për caktuar me ligjin organik, 9947/2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar. Në këto rrjedhe logjike, Gjukata Administrative mban parasysh edhe rregullimin ligjor të bërë nga neni 40, paragrafi 4, i ligjit 49/2012,*

sipas te cilit: "Gjykata vendos rrezimin e padise dhe kur vlereson se, pavaresisht shkeljeve procedurale te konstatuara te veprimtarise administrative, pasojat do te ishin te njejta". Ne rastin konkret object gjykimi Gjykata perfundimisht cmon se pavaresisht shkeljeve te pretenduara ne veprimtarine e pales se paditur, pasojat do te ishin te njejta. Si perfundim Gjykata e vlereson kerkesepadine si te pabazuar ne ligj, e si e tille duhet te rrezohet.shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane, bazuar ne nenet 126, 309 te K.Pr.Civile, K.Pr.A, si dhe ligjin nr.49/2012

VENDOSI:

Vendosi:

- Rrezimin e kerkesepadise se paditesit {...} -Albanaia sh.p.k.
- Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen pales paditese.
- Ndaj ketij vendimi mund te ushtrohet ankim ne Gj.Administrative te Apelit Tirane, brenda afatit prej 15 dite, afat i cili per palet prezent, fillon nga e nesermja e shpalljes, ndersa per palet ne mungese nga e nesermja e njoftimit te vendimit.

U shpall ne Tirane, sot me dt. 12.06.2017.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}